



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

### EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 06 mars 2019, në mbledhjen e IX-të (nëntë) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10:35.

Mbledhjen e hapi dhe deri në zgjedhjen e Kryesuesit e kryesoi Valbona Kadriu Podvorica, Zëvendës kryesuese e Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Benjamin Ejupi, Doruntina Hasani, Valmire Lahu, Albina Avdiu, Bashkim Syla, Mefail Rama ndërsa mungoi Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Bashkim Bajrami nga Policia Kufitare, Fadil Babatinca nga Stacioni Policor në Podujevë, Skender Shatri dhe Bekim Karaxhija përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të UNMIK dhe përfaqësues të KFOR - LMT.

### Miratimi i rendit të ditës

**Znj.Valbone Kadriu-Podvorica, zëvendës Kryesuese e Komitetit**, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit, i njoftoj rreth pikave të paraqitura në këtë rend të ditës dhe shtoi, nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës urdhëroni, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

*Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës*

### 1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 05.02.2019

*Njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 05 shkurt 2019*

### 2. Raport i punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për vitin 2018

**z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK**, theksoi, përshëndetje për të gjithë, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, do të mundohem që në pika të shkurtra t'i preku temat që janë më kryesore. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim është e obliguar të raportoj për punën e kësaj zyreje e cila është në kuadër të qeverisjes lokale, në bazë të rregullores, punët dhe aktivitetet që kryhen nga kjo zyrë në bashkëpunim me të gjitha Drejtorit në kuadër të mundësive që kemi kryejmë detyrat tona që i kemi obligative. Në kuadër të kësaj ne shpeshherë i caktojmë edhe shtyllat kryesore si Drejtori e që shumë tema dalin edhe jashtë sepse është normale që të gjitha çka janë të shkruara mund të mos kryhen sepse ka edhe tema të sektorëve të ndryshme rreth punëve tona, por në bashkëpunim edhe me organet lokale dhe me ato qendrore mundohemi që sipas mundësive para qytetarëve, me theks të veçantë edhe komuniteteve të ju ndihmojmë në integrimin e tyre në fushat na takojnë si qeveri lokale. Kuptohet që ky projekt ka edhe disa tema të veçanta edhe procesi i

kthimit të personave është proces që nga pas lufta, kthimi që është i pa tjetërsueshëm për ata persona që kanë prona, shtëpia është e drejtë e tyre legjitime që jetojnë në vendin e dytë sepse vendin e dytë e përfshijnë Republikën e Serbisë, Malin e Zi, Maqedoninë, dhe në kuadër të kësaj ata që kanë pasur prona më herët dhe ende kanë disa prona, ne si organe komunale e kemi obligim të ju krijojmë kushtet dhe hapësirën qoftë edhe juridike që të kthen në pronën e tyre. Shumë prej tyre e kanë bërë edhe shitjen e pronave, por ka ende prona të tilla, që ne merremi me këto qeshje në lirim të tyre prej atyre që kanë qenë uzurpues, me varrezat e tyre, me pronat, me ofrimin e kushteve të tyre, e që ka edhe të kthyer dhe më së shumti të kthyer kemi të komunitetit pakicë si Romë, Ashkali dhe Egjiptas, kurse më pak ka nga komuniteti Serb e që kanë qenë një pjesë numerikisht më e madhe dhe ne si ZKKK kemi qenë të përgatitur edhe për këtë proces të cilin e kemi kryer mjaft mirë duke i falënderuar edhe sektorët dhe Drejtorit përkatëse për kompletimin e dokumentacionit, si dhe organet tjera siç është Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe të gjitha strukturat me të cilat jemi të lidhura qoftë ato lokale apo qendrore për një kthim të qëndrueshëm. Në vitet e mëparshme ka pasur kërkesa dhe i kemi shqyrtuar ato dhe ka qenë edhe taskforcë e grupe punuese, mirëpo në vitin 2018 nuk kemi pas ndonjë krekës të tillë, pavarësisht që jemi të hapur në këto procese, madje kemi edhe strategji se si kemi punuar edhe më parë për shumë vite dhe ky është një proces që vazhdon, për të gjithë njerëzit që duan të kthehen në vendin e tyre sepse është e drejtë legjitime e tyre dhe ne si Komunë apo qeverisje lokale në bashkëpunim edhe me organizatat ndërkombëtare, të cilat i falënderoj siç janë OSBE, UNHCR dhe shumë tjera të cilat kanë qenë të gatshëm çdo herë për vazhdimin e këtij procesi.

Detyrë shtesë i kemi edhe personat e riatdhesuar e që ne e dimë që në vitin 2014-2015 ka qenë një fluks i madh i të rinjve kryesisht që kanë depërtuar në vendet perëndimore dhe në kuadër të kësaj ka qenë një marrëveshje obligative e që ka bërë Qeveria që pas shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, deri më 28.10.2010, ndërsa pas vitit 2010 nuk ka ndonjë person që i takon azil politik apo ekonomik në vendet perëndimore. Me këtë proces të riatdhesimit ne si ZKKK merremi edhe sot e kësaj dite bashkërisht me zyrtarin për integritime evropiane, procese këto që janë të rregulluara me Rregullore dhe dokumente tjera përkatëse që organe të Komunës i lëshojmë dhe pastaj janë procedurat tjera në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrin e Punëve të Brendshme dhe me të gjithë sektorët tjerë që këta persona që kthehen në vendin e tyre të origjinës, jemi të obliguar t'i ndihmojmë me të gjitha mundësit që i kemi.

Në kuadër të kthyerve ne kemi edhe shumë nxënës dhe duke falënderuar Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë bëhen disa trajnime enkas dhe vazhdojnë procesin mësimor dhe nuk kemi ndonjë problem. Ne si Komunë e kemi edhe komisionin që del në teren dhe shikon për gjendjen e personave që janë lajmëruar tek ne.

Gjatë vitit 2018 në Komunën tonë ka ngritje të numrit të atyre që kthehen, ku numri i të riatdhesuarve është 183 persona, 60 prej tyre kanë qenë familjarë, të tjerët që kanë qenë individual prej tyre 35 kanë qenë nxënës të komuniteteve jo shumicë. Në bashkëpunim me komisionin dhe me zyrtarin për integritime evropiane, 10 familje kanë përfutur strehim të përkohshëm e që jemi të detyruar me zgjedh një vend për ata ku për 6 deri në 12 muaj pagesat i bënë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Punëve të Brendshme, 5 familje kanë përfutur tretmanë mjekësor dhe medikamente, 6 familje kanë përfutur pako dimërore (dru për ngrohje), 3 familje kanë përfutur orendi shtëpiake, 6 familje janë hyrë ne asistencë sociale. Ne si Institucione jemi mundu që asnjë familje mos të mbetet në luftë për ekzistencë, po ashtu në Qendrën për Punë Sociale ju kemi rregulluar dokumentacionin e nevojshëm në mënyrë që ata ti shfrytëzojnë të drejtat që ju takojnë, pastaj kemi shumë të atillë që kanë aftësi në një profesion dhe ne dokumentacionin ua kompletojmë ku pastaj e kanë të drejtën e një aftësimi shtesë në Zyrën e entit profesional dhe në

fund certifikohen. Kemi edhe projekte për xehetari në kuadër të të cilit mund të jenë përfitues dhe të kenë mundësi të krijojnë të hyra dhe të mbajnë familjet e tyre. Kuptohet ne çdoherë kemi vepruar në kuadër të Planit të veprimit për riintegrimin apo integrimin e komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptas, ku në të cilin si shtylla kryesore janë paraparë shëndetësia, kultura, arsimit, infrastruktura etj, ku si shtyllë më e rëndësishme është ajo e arsimit. Ne vazhdimisht kemi përcjellë statistika që nga pas lufta dhe mund të themi se kemi ngritje çdo vit, fjala është për nxënësit e Komuniteteve jo shumicë ku për vitin 2018, kemi 195 nxënës, gjë e cila na bënë të mendojmë se ka një ngritje në arsim për një shoqëri të shkolluar. Në këtë aspekt falënderoj edhe OJQ-në "Qëndrimi" e cila ka ndihmuar dhe ka bashkëpunua rregullisht, ku vetëm në vitin shkollor 2018/2019 deri tani, 26 nxënës janë kompletuar me gjëra mësimore dhe 2 studentë me bursa nga një organizatë jo qeveritare që quhet "Voice of Roma" e cila është një Organizatë Zvicerane dhe ka vite që kjo organizatë, Komunën tonë e ndihmon me bursa. Sa i përket vijueshmërisë së shkollimit i kemi në shkollën fillore 161, në të mesmen 34 nxënës dhe 5 studentë, ndërsa shqetësimi më i madhe është punësimi. Kemi më shumë persona që lajmërohen për ta vazhduar qeshjen sociale që është shumë e rëndësishme për ta.

Kemi disa projekte shtesë për strehim dhe asistencë sociale, si pako ushqimore higjienike, kemi kërkesa edhe për më shumë por buxheti nuk është shumë i madh dhe nuk mund të përballoj këtë.

Sa i perfekt infrastrukturës nga komitetet jo shumicë kemi disa kërkesa për asfaltimin e rrugicave, dy familje për ndërtim të shtëpive kanë përfituar nga Gripi 6 plus në Kuvendin e republikës së Kosovës, sipas dokumentacionit që kanë poseduar, dhe si lëndë ka kaluar, tash mbetet në kuadër të Qeveris ti vazhdoj procedurat në mënyrë që ato familje të bëhen me shtëpi të reja.

Sa i përket kulturës, rinisë dhe sportit, sa i përket kësaj kemi hapësirë të madhe edhe në media lokale që ju kushtohet këtij komuniteti, dhe jemi duke vazhduar të ju krijojmë kushte edhe në parqe në disa fusha të vogla të futbollit dhe të tjera.

**znj.Doruntina Hasani**, theksoj, desha të ngris si shqetësim sa i përket punësimin të pjesëtarëve të komunitetit jo shumicë ku prej 1954 personave që janë të punësuar në institucioneve komunale, vetëm 10 prej tyre janë të komunitetit në fjalë, dhe vetëm 0.5% janë femra.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, është e vërtet ajo që tha parafolësja, edhe unë e ngrehi si shqetësim një gjë të tillë, dhe në kuadër të kësaj interesimi i tyre më i madhe ka qenë në FSK dhe Polici. Tani kemi pjesëtar të Komuniteteve jo shumicë të angazhuar si praktikant me pagës të cilët paguhen nga buxheti i Qeverisë qendrore dhe kjo është diçka e mirë. Në kuptimin numerik është ajo që e tha parafolësja, por konkurrenca dhe kualifikimi në shkollim ka avancuar dhe për këtë arsyeje mbeten më pak në numër.

**z.Bashkim Syla**, theksoi, kam një këshillë, në tetor të vitit 2018 kemi pas një mbledhje dhe pik e rendit të ditës ka qenë shqyrtimi i mundësive për gjetjen e donatorëve eventual për sigurimin e lëndëve djegëse për familjet në nevojë, por nuk ka qenë e cekur për komunitete jo shumicë, zyrtari komunal nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale pati treguar që nuk ka mjete në Drejtori për një ndihmë të tillë por me rastin e miratimit të buxhetit mund të planifikojmë. Pra kjo është vetëm si sugjerim që të planifikohen dhe të kërkohen mjete buxhetore në mënyrë që familjet e komuniteteve jo shumicë duke mos përjashtuar edhe ato të komuniteteve shumicë, të ndihmohen me lëndë djegëse, andaj konsideroj se mos planifikimi mirë i buxhetit po shkakton probleme, shembull kemi projekte që kanë mbete në gjysmë dhe pas 2 viteve duhet të ndryshohen në tërësi, pra i gjithë problemi është mos planifikimi i mirë i buxhetit. Madje kemi informacione që 2 milion euro janë mbet suficit, dhe të njëjtat i kthehen Qeveris, mirëpo të mos realizohen shumë projekte në Komunën tonë nuk është e drejtë, nëse ishin shpenzuar ato para në Komunë, sigurisht që do të ishin ndihmuar edhe më shumë komunitetet.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, nuk jam i thirrur për departamente të caktuara, por ajo që më shqetëson është mos menagjimi i mirë e buxhetit dhe dikush duhet të japë përgjegjësi këtu, disa vite më herët Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka bërë sekuestrimin e lëndëve djegëse të prera ilegalisht dhe ka depozituar në vendin adekuat që gjendet në Peran, por në kuadër të kësaj ka qenë një kërkesë që ka qenë prej Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural konkretisht nga Departamenti i Pylltarisë që nuk ka të drejtë Drejtoria të bëjë shpërndarjen e drunjtëve për raste sociale, por vetëm duhet t'i nënshtohen ankandit publik përkatësisht të shiten, e që sigurisht jemi në dijeni se çmimi do të ishte i vogël, ndërsa pastaj Komuna përmes prokurimit do të duhej të blente dru për ngrohej dhe të njëjtat t'i shpërndaj për familjet me gjendje të rëndë sociale ekonomike, pra dua të them se Ligji e ndalon që drunjtë e konfiskuar të mund t'iu shpërndahen ndokujt.

### **3. Informatë për realizimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2018**

**z.Benjamin Ejupi**, theksoi, në kuadër të planit të punës që e kemi pas në vitin 2018 kemi vizituar një shkollat fillore në Batllavë dhe në Orllan dhe gjithashtu familjen e anëtarit të komitetit pakicë Radisav Perović, në kuadër të kësaj vizite kemi takuar edhe Drejtorin e shkollës në Batllavë, shkollës fillore "Lluaigj Gurakuqi" kemi fol për gjendjen e nxënësve të komuniteteve dhe na është thënë se gjendja nuk është e mirë si dhe interesimi për mësim është i dobët dhe nxënësit janë të dobët. Numri i nxënësve nëpër këto klasë ishte gjithsej 5, ku 1 është i gjinisë mashkullore dhe 4 të gjinisë femërore, të dhëna nga të cilat numri i paraqitur në raportin e ZKKK-së nuk korrespondon.

Kjo nuk do të thotë që ZKKK nuk e ka paraqit numrin e saktë por që Drejtori i shkollës nuk kishte pasur listën dhe është deshtë përmes telefonit të informohet për numrin e tyre. Gjithashtu gjatë vizitës në shkollën fillore "Zahir Pajaziti" në Orllan u takuam me Drejtorin z.Zejadin Zeqiri, në këtë shkollë vijojnë shkollimin 4 nxënës ndërsa në shkollën e mesme 2 nxënës, por që po ashtu nuk korrespondon me numrin e paraqitur nga ZKKK. Gjithashtu është vizituar edhe fshati Metergovc (lagja e Sekiraqve) në shtëpinë e Radisav Perović dhe kemi biseduar për kushtet që u jep ky vend për të jetuar, të pranishëm në këto vizita ishin edhe ish kryesuesi i Komitetit tani i ndjerë Shaban Ahmeti, ne antarët e Komitetit për Komunitete dhe Policia e Kosovës.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, përgjigje parafolësit, unë si shef i ZKKK, statistikat i marrë nga Drejtoria e Drejtorisë së Arsimit, dhe statistikat nuk ndryshojnë por janë të sakta dhe të njëjtat i kemi në zyrë.

### **4. Të ndryshme**

Nuk pati diskutime

**Mbledhja përfundoi në orën 11:30'**

**Procesverbalin e mbajti**

**Enis Sheholli**

**Nr. 01-060/04-0026380/19**

**Podujevë,**

**06 mars 2019**

**zv.Kryesuese e Komitetit  
Valbona Kadriu-Podvorica**